



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1247/2 prot.

Datë 21.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GREEMED” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01902-04-18-2024, me objekt: “Furnizim Vendosije pajisje Mjekësore Kolonë Endoskopie” për QSRT “Shefqet Ndroqi”, me fond limit 9,925,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “MONTAL” SHPK me NIPT J62009007F dhe adresë: Rruga Dervish Hima-3kullat K.3 Ap9/2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi
Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “GREEMED” SHPK me NIPT K91329017I dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Ramazan Demneri, Ndertesa Nr.1, Hyrja 13, Kodi Postar 1022, Tiranë.

Në datën 20.05.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4100, si dhe nr. protokoli 1247/2024 datë 20.05.2024, i operatorit ekonomik “MONTAL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01902-04-18-2024, me objekt: “Furnizim Vendosije pajisje Mjekësore Kolonë Endoskopie” për QSRT “Shefqet Ndroqi”, me fond limit 9,925,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GREEMED” SHPK në procedurën e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**”.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se ofertuesi “GREEMED” SHPK nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 e më konkretisht:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KOLONË ENDOSKOPIE FULL HD PËR SALLËN OPERATORE

Videoprocesori

...

Njësia e kontrollit minimumi dy hyrje kamerash.

Të lidhet me endoskop të ngurtë dhe fleksibël (video- dhe fibro-bronkoskope).

...

Ruajtja e të dhënave, imazheve dhe filmimeve Full HD në kujtesën e brendshme të integruar dhe transferimi i tyre në USB/CD.

...

Kamera endoskopike

...

E sterilizueshme.

...

Monitor mjekësor, Full HD

...

Ndriçimi maksimal minimumi 850 cd/m².

...

Burimi i dritës LED

...

Me ekran tregues për orët e punës të llampës dhe mesazhe funksionimi.

...

Insuflatori me CO₂

..

Minimumi dy mënyra pune, për të rritur dhe fëmijë.

Me monitorim të presionit endokavitar, të rregullueshëm nga 1-30 mmHg.

...

Sistem për irrigim dhe aspirim

...

Rregullimi i presionit të irrigimit minimumi 400 mmHg.

...

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 21.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro